

Ç'do të thotë nevoja speciale arsimore?

Nevoja speciale arsimore mendohet se kanë fëmijët dhe të rinjtë që në mundësitet e tyre të zhvillimit dhe të mësimit kanë aq disavantazhe afatgjata, sa pa një ndihmë speciale arsimore gjatë mësimit nuk mund të arrijnë suksese të mjaftueshme mësimore.

Për të mësuar në mënyrë të suksesshme, ata kanë nevojë përkushte të veçanta dhe ndihma individuale përtëj masava të përgjithshme arsimore.

Nevojet speciale arsimore mund të konstatohen në fushën e mësimit, të zhvillimit mendor, të zhvillimit emocional dhe social, të zhvillimit fizik dhe motorik, në fuhën e dégjimit si dhe të shikimit.

Ç'është Shërbimi Mobil për Nevojet Speciale Arsimore (MSD)?

Shërbimi Mobil për Nevojet Speciale Arsimore përbëhet prej mësimdhënësish që kanë njojuri specifike në fushën e diagnostikës dhe ndihmës speciale arsimore. Ata kontrollojnë nivelin aktual të mësimit dhe të zhvillimit të fëmijës suaj, burimet në dispozicion dhe jepin rekomandime për ndihmën speciale.

Si mund të jepni kontributin tuaj?

Krahas marrjes pjesë në mënyrë aktive në bisedat dhe këshillimet, ju mund të ndihmoni mjaft në marrjen e vendimeve duke e furnizuar MSD-në sa më herët e mundur me të gjitha kopjet e dokumenteve qe kanë lidhje me rastin. Mes të tjerash këto janë:

- dokumentet terapike / mjekësore /psikologjike (p.sh. logopedi, ergoterapi, fizioterapi, Qendra Socialpediatrike, Qendra e Autizmit)
- Rekomandimet nga kontrolli i përgjithshëm para hyrjes në klasë të parë
- raportet dhe diagnozat mjekësore
- raportet shkollore psikologjike
- dokumentimi i zhvillimit nga kopshti dhe nga programit i ndihmës së hershme
- plani pedagogik i zhvillimit

Nëse tek fëmija juaj konstatohet një nevojë speciale arsimore, atëherë gjatë kalimeve si p.sh. kalimi nga shkolla fillore në shkollën e mesme, duhet të krijohen kushte që të mund të vazhdohet me sukses programi ndihmues. Prandaj ju duhet ta informoni menjëherë shkollën e re për ndihmën speciale që merr fëmija juaj dhe të dorëzoni aty dokumentet përkatëse si expertizat, planet ndihmuese dhe raportet e zhvillimit.

Të gjitha bazat ligjore i gjeni në internet tek www.revosax.sachsen.de:

- Ligji shkollor për Shtetin e Lirë Sachsen (SächsSchulG)
- Rregullorja shkollore për shkollat speciale (SOFS)
- Rregullorja shkollore për shkollat fillore (SOGS)
- Rregullorja shkollore për shkollat e mesme të larta dhe ato të natës (SOOSA)
- Rregullorja shkollore për shkollat integrative (SOGES)
- Rregullorja shkollore për gjimnazet, provimi i maturës (SOGYA)
- Urdhri administrativ për nevojat speciale arsimore dhe këshillimin [VwM Muster sonderpädagogischer Förderbedarf und Beratung]

Publikimi dhe redaktimi: Zyra e Arsimore e Landit, Reichenhainer Straße 29 a, 09126 Chemnitz, Telefon: +49 371 5366-0, E-mail: poststelle@lasub.smk.sachsen.de, www.lasub.smk.sachsen.de

Dizenjimi dhe grafia: September Markenführung GmbH

LANDESAMT FÜR
SCHULE UND BILDUNG



Freistaat
SACHSEN

Në hapat e duhur

Informacion për prindërit rreth konstatimit të nevojave speciale arsimore

Të dashur prindër,

mendohet se fëmija juaj ka nevojë për ndihmë speciale arsimore. Ky supozim duhet të kontrollohet më tej. Që këtë kontroll mos ta merrni me frikë, shqetësim dhe pyetje, duam t'ju informojmë për hapat e këtij procesi dhe për detaje të rendësishme.

Për ne është shumë e rendësishme që ju, si ekspert i fëmijës suaj t'ju përfshijmë që në fillim. Ju e njihni fëmijën tuaj dhe dëshironi për zhvillimin e tij shanset më të mira të mundshme. Mësuesit e shkollës së fëmijës suaj dhe ata të shkollës speciale ju qëndrojnë pranë me këshillat e tyre si ekspertë të ndihmës shkollore.

Kjo broshurë ka për qëllim t'ju japë një përbledhje fillestare për termat më të rendësishme dhe për hapat e këshillimit dhe të procesit të konstatimit të nevojave speciale.

**SONDERPÄDAGOGISCHE
DIAGNOSTIK
UND FÖRDERUNG**



1. Këshillim¹

Qëllimi

Këshillim për nevojën e ndihmës speciale, për burimet dhe vete ndihmën speciale

Përbajtja

- biseda me ata që janë të përfshirë në zhvillimin e fëmijës
- nëse është e nevojshme vëzhgimi i fëmijës dhe i mjedisit të tij mësimor
- analizë e raporteve mjekësore², psikologjike dhe terapike³

Pjesëmarrësit⁴

- ju si prindër
- fëmija juaj
- mësuesit (ose edhe edukatorët⁵)
- mësuesi i MSD-së⁶

Rezultati

Mësuesi i MSD-së⁶ përpilon një protokoll të rezultateve me rekomandime

- pér ndihmën speciale individuale të fëmijës suaj në shkollë,
- masat ndihmuese jashtëshkollore nén përgjegjësinë e prindërve,
- nëse ka nevojë pér këshillim të mëtejshëm dhe
- nëse ka nevojë pér nisjen e procedurës pér konstatimin e nevojave speciale arsimore.

Kërkesën pér procedurën e konstatimit të nevojave speciale mund ta shtroni vetë ju ose shkolla ku mëson fëmija juaj.

2. Diagnostika¹

Qëllimi

Për të gjetur nëse ka nevojë pér ndihmë speciale

Përbajtja

- Diagnostika speciale arsimore, p.sh.:
- biseda me të përfshirët në zhvillimin e fëmijës tuaj
 - vëzhgimi i fëmijës dhe i mjedisit të tij mësimor
 - teste
 - analizë e raporteve mjekësore², psikologjike dhe terapike³

Pjesëmarrësit⁴

- ju si prindër
- fëmija juaj
- mësuesit (ose edhe edukatorët⁵)
- mësuesi i MSD-së⁶

Rezultati

Mësuesi i MSD-së⁶ përpilon një raport me nevojat speciale arsimore, i cili përmban

- konstatime se pér ç'nevoja speciale bëhet fjalë,
- rekomandime pér zgjedhjen e rrugës arsimore dhe të vendit të shkollës,
- propozime pér llojin e ndihmës dhe
- përshkrimin se ç'kushte duhet të plotësohen në shkollë dhe gjatë mësimit.

Ju do të merrni një kopje të raportit.

3. Komisioni i programit ndihmues

Qëllimi

Rekomandime pér përgatitjen e programit ndihmues

Përbajtja

- sqarim i raportit dhe i kushteve që mundësojnë një ndihmë të suksesshme
- mundësi pér pyetje dhe diskutim
- mendimet e të gjithë të përfshirëve

Pjesëmarrësit⁴

- ju si prindër
- fëmija juaj⁷
- mësuesit
- nëse nevojitet, drejtoria e shkollës
- mësuesi i MSD-së⁶

Rezultati

Rezultatet do të shkruhen në një protokoll.

Nëse ka nevojë pér ndihmë speciale arsimore, ju si prindër parimisht keni mundësi të zgjidhnë nëse doni që fëmija të marrë pjesë në një mësim inkluziv në një shkollë të zakonshme apo të marrë ndihmë intensive në një shkollë pér nevoja speciale. Drejtoria e shkollës vendos nëse e pranon fëmijën tuaj në atë shkollë.

Raporti dhe protokoli i rezultateve të komisionit të programit ndihmues shërbejnë si bazë pér deklaratën e Zyrës Arsimore të Landit.

4. Ndihma speciale

Qëllimi

Përgatitja e proceseve të suksesshme të zhvillimit dhe mësimit

Përbajtja

- ndihmë individuale me një qëllim të caktuar
- diagnostikë shoqëruese e nevojave (speciale) arsimore
- këshillim dhe asistencë pér nevojat speciale arsimore

Pjesëmarrësit⁸

- ju si prindër
- fëmija juaj
- mësuesit
- asistentë të tjera pedagogjikë / edukatorë
- mësues të nevojave speciale

Rezultati

Se ç'nevojë speciale ka fëmija, kjo varet nga niveli individual i zhvillimit të fëmijës suaj dhe kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme. Kjo do të thotë se gjatë rrugës shkollore, nevoja pér ndihmë speciale mund të anullohet përsëri.

1. Kërkesa pér këshillim nga MSD⁶ si dhe kërkesa pér konstatimin e nevojave speciale mund të bëhet nga shkolla ose nga prindërit.
2. Nëse është e nevojshme do të përfshihet shërbimi mjekësor pér fëmijë dhe të rinj. Për fëmijët që hyjnë në klasë të parë, do të merren parasysh edhe rekomandimet nga kontrolli i përgjithshëm parashkollor.
3. Një diagnozë mjekësore nuk do të thotë automatikisht se fëmija ka nevojë pér ndihmë speciale arsimore.
4. Me lejen e prindërve mund të kontaktohen edhe persona ose institucione të tjera.

5. Tek fëmijët parashkollorë, në diagnostikë dhe këshillim do të përfshihen edukatorët e kopshtit.
6. Shërbimi Mobil i Nevojave Speciale
7. Pjesëmarrja e fëmijës suaj cakohet nga një vendim i përbashkët sipas aspekteve individuale.
8. Mund të përfshihen persona të tjera si dhe partnerë apo bashkëpunues jashtëshkollorë.